



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 4.11.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit**

Në mbledhje **morën pjesë**: Ibrahim Selmanaj, Zulfi Merxha, Elhëme Hetemi, Myrvete Pantina, Berat Luzha, Selvie Halimi, Heset Cakolli, Zef Morina, Kosara Nikoliq dhe Ali Lajçi, Lulzim Zeneli. Munguan : Kosara Nikoliq, Zef Morina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga MMPH Nazmi Shkodra etj, eksperti i mjedisit Tush Markaj

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : **Ibrahim Selmanaj**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

**2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit**

**Kryesuesi** shkurtimisht njoftoi me përmbajtjen e rendit të ditës e cila plotësohet me disa shtesa sa i përket pikës të ndryshme.

Kryesuesi ja dha fjalën **Selvie Halimit** lidhur me projektligjin për Mjedisin, e cila kërkoi sqarime lidhur me kërkesat e komisionit nga mbledhja e kaluar. **Nezakete Hakaj** në vazhdim i dha sqarimet si vijon :

1. Definicioni” **Leje mjedisore**” është dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria, në pajtim me Ligj, e kërkuar me qëllim që të merret leja e punës.

2. **Neni 32**, Mendojm se duhet të mbetet.

3. **Neni 39.**

Çdo person **që është i njoftuar** për dëmtim të mjedisit ose për aksident mjedisor, duhet të njoftojë Inspektoratin për mbrojtjen e mjedisit ose organin tjetër përgjegjës.

4. Përkufizimi për etiketën mjedisore

Janë konsultuar Direktivat evropiane, mirëpo nuk egziston definicion për etiketën mjedisore.

**Neni 43.** riformulohet dhe merr këtë formë:

- (1) Prodhimet për konsum të gjërë mund të shpërblehen me etiketën mjedisore, nëse prodhimi, distribuimi, konsumimi dhe depozitimi final i prodhimit kanë ndikimin më të ulët në mjedis se prodhimet e njejtë të cilat i përgjigjen rregullave që janë në fuqi.
- (2) Kushtet dhe procedurat për përvetësim dhe shfrytëzim të etiketës do të përcaktohet me akt të veçant, nga Ministria.

5. **Neni 46**

Importi, eksporti dhe kalimi transit i kimikateve të rrezikshme, mallrave të kontrolluara, materieve radioaktive dhe të rrezikshme dhe mbeturinave të rrezikshme rregullohen me akte të veçanta ligjore

6. **Neni 49, paragrafi 3**

(3) Nëse vërtetohet ndotësi i cili është përgjegjës për aksidentin mjedisor, institucioni i cili i ka bartë shpenzimet për mënjanimin e pasojave të ndotjes së mjedisit ka të drejtë në kompenzimin e shpenzimeve, nga ndotësi i identifikuar.

7. **Neni 51**

1. Çdo person juridik ose fizik i përfshirë në aktivitete të vazhdueshme që paraqesin burim të ndotjes, është i detyruar që në pajtim me ligj të sigurojë:
  - a) monitorimin e emisionit dhe **cilësisë së mjedisit**;
  - b) bartjen e shpenzimeve të matjes së emisionit dhe **parametrave të cilësisë së mjedisit**, në zonën e ndikuar;
  - c) mbajtjen e shënimeve për ndotjen e mjedisit, që duhet të përmbajnë të dhëna për energjinë dhe materiet e përdorura;
  - d) përcjelljen e efekteve të aktiviteteve që ndikojnë në mjedis, mirëmbajtjen, llojet dhe nivelin e ndotjes, substancave të rrezikshme apo mbeturinave të rrezikshme.
2. Të dhënat nga paragrafi 1. të këtij neni, subjektet përgjegjëse, janë të detyruar **të ia** dërgojnë Ministrisë.
3. Qeveria, me **akte ligjore**, përcakton llojin e emisionit, parametrat për **cilësinë e mjedisit** dhe të dukurive tjera të cilat janë subjekt i monitorimit të **ndotjes**, metodologjinë e matjeve, marrjen e mostrave, mënyrën e evidentimit, afatet e dorëzimit dhe ruajtjes së të dhënave.
4. Mendojmë që paragrafi (4) i propozuar nuk është i nevojshëm pasi që në paragrafin (4) të Nenit 52 është përfshi mënyra e informimit të publikut

5. **Përkufizimi për**

“**Kadastr i ndotësve**” është grup i të dhënave për burimet e ndotjes, llojin sasinë, mënyrën dhe vendin e shkarkimit, rrjedhjen apo vendosjen e materieve të dëmshme në mjedis, për stabilimentet dhe paisjet për mbrojtjen e mjedisit si dhe proceset të cilat përdoren për mbrojtjen e mjedisit, të cilat të dhëna mbëlidhen për periudhën e vitit kalendarik.

#### 5. Neni 55.

Informacionet mbi të dhënat për mjedisin, Ministria ia ofron paraqitësit të kërkesës, në afatin prej tridhjetë ditësh, nga dita pranimit të kërkesës

#### 6. Neni 57

propozojmë ndryshimin e titullit të nenit

#### **Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje**

#### 6. Neni 59

1. Agjencioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (këtu e tutje AKMM) është institucion në kuadër të Ministrisë i cili kryen punë në hulumtimin dhe dhënjen e mendimeve profesionale për çështje mjedisore

2. AKMM do të vazhdon me punën e tij në fushat e përkrahura me këtë ligj.

#### 7. Neni 60, merr këtë formë

1. Detyrat e AKMM janë:

- a) të siguroj informacione të duhura për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- b) të zhvilloj dhe koordinoj sistemin e informimit për mbrojtjen e mjedisit, lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledhë shënimet për mjedisin;
- c) ti vendosë dhe ti mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e gjendjes së mjedisit (shënimet socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
- d) të zhvillojë procedurat për përpunimin e shënimeve të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
- e) të kryej punët profesionale këshillëdhënëse gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit, përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- f) të avancojë dhe krahasojë cilësinë e të dhënave për mjedisin;
- g) të hartojë raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, si dhe të raportojë për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin, llojllojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike);
- h) të hartojë raporte për çështjet e caktuara, për mbrojtjen e mjedisit
- i) të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit
- j) në bazë të autorizimit të Ministrit, bashkëpunon me institucionet ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së mjedisit,
- k) të sigurojë qasjen në të gjitha informacionet për mjedisin e Kosovës dhe të mundësojë shfrytëzimin dhe këmbimin e tyre.

2. AKMM kryen edhe punë të tjera, për realizimin e veprimtarisë për çështjet e mbrojtjes së mjedisit

#### 8. Neni 63, ndryshon edhe titulli në **Vetmonitorimi nga ndotësit**

1. Personi juridik dhe fizik, përkatësisht operatorët, që paraqesin burim të emisionit dhe të ndotjes së mjedisit, janë të detyruar që në përputhje me ligj, përmes institucioneve të caktuara, dhe organizatave të autorizuara të:

- a) kryejë monitorimin e emisionit dhe cilësisë së mjedisit;

b) përcjellë edhe ndikimet e tjera nga aktivitetet e tij, në mjedis,

2. Ndotësi me mjete vetanake kryen, monitorimin e emisionit dhe cilësisë së mjedisit dhe përcjelljen e ndikimit të aktiviteteve të veta në mjedis.

**Tush Markaj** nuk u pajtua me propozimin e MMPH rreth nenit 59 dhe 60 sepse si tha agjensioni duhet të jetë instrument i ministrisë në aspektin profesional, e jo agjension i burokracisë.

**Blerim Vela** kërko spastrimin e afatit tek neni 55, të mbetet 30 apo ndryshe, për çka komisioni tha se do të vendoset më vonë. Sipas sugjerimit nga **Selvie Halimi**, komisioni nxori :

### K O N K L U D I M

-Në tërë tekstin e projektligjit fjala “imision” zëvendësohet me “cilësi e mjedisit”.

- Miratohen sugjerimet e lartshënuara nga MMPH, ndërsa zyrtari nga OSCE **Blerim Vela** të sjellë shkresën komisionit ku do të sqaroi përvojat e shteteve të rajonit rreth agjencionit për mjedis, pastaj vendos komisioni. Neni 59 dhe 60 mbetet të ridefinohet nga komisioni.

-Në mbledhjen e radhës pasi të analizohet shkresa nga OSCE komisioni do të rishikoi të gjitha amendamentet e deritanishme duke inkorporuar ndryshimet e sotme dhe një përkufizim që duhet të dërgoi MMPH.

Të ndryshme

**Komisioni mori** njoftimet e reja rreth fushveprimtarisë së vet, ndaj nxori :

### P Ë R F U N D I M

1.Projektligji për Inspektionin Bujqësor procedohet për leximin e dytë, pasi që është kthyer nga komisionet kryesore pa vërejtje.

2.Caktohet grupi punues për VNM dhe VSM : **Selvie Halimi, Zef Morina dhe Ibrahim Selmanaj.**

3.Caktohet vizita në Pejë-Komunë për datën 19 nëntorë.

4.Për seminarin e nesërm transporti është në orën 9,45 prej Kuvendit.

5. Ju shpërndahet delegacionit për Hungari agjenda e vizitës për datën 10-13 nëntor.

Mbledhja përfundoi në orën 14,50

Kryesuesi i Komisionit,  
**Ibrahim Selmanaj**